LIGJ
Nr. 90/2020

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 46/2018, "PËR KONTROLLIN SHTETËROR TË TRANSFERIMEVE NDËRKOMBËTARE TË MALLRAVE USHTARAKE DHE TË ARTIKUJVE E TEKNOLOGJIVE ME PËRDORIM TË DYFISHTË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Pika 1, e nenit 26, të ligjit nr. 46/2018, ndryshohet si më poshtë:

"1. Për lëshimin e licencave/autorizimeve apo të certifikatave në transferimin ndërkombëtar të mallrave, personi fizik ose juridik paraqet kërkesën pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtim dhe për vlerësim. Këto dokumente, të cilat i bashkëlidhen kërkesës, përmbajnë të dhëna të sakta për mallrat dhe procedurat e transferimit ndërkombëtar të tyre, si dhe dokumentet e garancisë origjinale për këto transferta.".

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.7.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11555, datë 17.7.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.